



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 34, Datë 09.02.2018**

**MBI**

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALESIO – 2014” SH.P.K NË AKTIVITETIN E  
PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA HEC “KRYEZI” ME FUQI TË  
INSTALUAR 1990 KW.**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2 gërma “a”, 39 pika 3 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a” dhe 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 09.02.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “ALESIO-2014” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kryezi” me fuqi të instaluar 1990 KW,

**Konstatoi se:**

- Me shkresën nr. 818 Prot i ERE, datë 26.12.2017, shoqëria “ALESIO – 2014“ sh.p.k., ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec “Kryezi”.
- Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, në nenin 38, pika 1, gërma “a” përcakton se : “afati i vlefshmërisë së licencës, për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;”
- Jo me vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës.
- Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 13, datë 10.01.2018 filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “ALESIO-2014“ sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Kryezi”.

- Aplikimi i shoqërisë “ALESIO-2014” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “ALESIO – 2014” sh.p.k., në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec “Kryezi” me fuqi të instaluar 1990 KW, për një afat 30 - vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**